

Kreditimi i ekonomisë gjatë vitit 1998 dhe parashikimi për vitin 1999.

Banka e Shqipërisë në programin e saj monetar, ndër të tjera, parashikon rritjen e kërkesës së parasë nga kredia për ekonominë.

Mbështetja e ekonomisë me kredi është një nga detyrat kryesore të sistemit bankar, e lidhur ngushtë kjo me kushtet specifike të vendit tonë si:

- niveli i prapambetur i teknologjisë dhe i infrastrukturës,
- kërkesat e reja që shtron tranzicioni,
- mundësitë natyrore që ofrohen dhe mungesa e aktiviteteve që zhvillohen mbi bazën e tyre,
- elementet e reja të kapitalizmit në biznes dhe konkurrenca e huaj.

Për të kontrolluar ekspansionin e parasë nga krediti për ekonominë¹, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e kufirit të kreditit² që në fillim të aktivitetit të saj si bankë qendrore e vendit. Për këtë qëllim, në përputhje me objektivat kryesorë të programeve ekonomike, është përcaktuar, në fillim të çdo viti, rritja e gjendjes së kredive në sistemin bankar.

Kufiri i kreditit i parashikuar në programin monetar për vitin 1998 ishte fillimisht 6 miliardë lekë dhe më vonë u rishikua në 2,5 miliardë lekë.

Në fillim të vitit 1998 gjendja e kredive në bankat e nivelit të dytë ishte:

	(në milionë lekë)	
	Bankat shtetërore+B.Dardania	Bankat private
Teprica e kredisë	13127.7	2707.3
<i>Kredi afatshkurtër</i>	4364.3	1953.7
<i>Kredi afatgjatë</i>	8763.4	753.6
Nga kjo :		
Kredi me probleme	9236.7	302.3
<i>Afatshkurtër</i>	3838.7	185.3
<i>Afatgjatë</i>	5398	118

Kreditimi i ekonomisë për këtë vit u kanalizua nëpërmjet bankave private dhe të përbashkëta, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë. Bankat me kapital shtetëror BKT, BK dhe Banka Dardania u përjashtuan nga e drejta për përdorim kufi kredie.

Për vitin 1998, ecuria e kredisë së brendshme me dy kategoritë e saj:

- kreditinë për qeverinë,
- kreditinë për ekonominë, paraqitet:

¹ Termin kredi për ekonomine do ta përdorim për kredine e sistemit bankar jo për qeverine.

² Kufiri i kreditit i shprehur në gjuhën e programit monetar është 'tavani i kredive'.

	% e kredisë ndaj kredisë së brendshme 1998				
	dhjetor97	T1	T2	T3	T4
kredia për qeverinë	91.3	90.9	91.1	91.3	91.5
kredia për ekonominë	8.7	9.1	8.9	8.7	8.5

Nga sa më lart, vëmë re që kredia për qeverinë zë peshën kryesore në totalin e kredisë së brendshme, prandaj edhe për vitin 1998 defiçiti buxhetor ka qenë burimi kryesor i ekspansionit të kërkesës për para.

Fakti që sektori publik përbën mesatarisht 91 për qind të kreditit të brendshëm, tregon se pjesa më e madhe e parave, pra e depozitave shkon për të financuar sektorin publik në shpenzime që në pjesën më të madhe janë joproduhuese. Dihet që investimi në bono thesari nga ana e bankave të nivelit të dytë është një investim me risk minimal. Por, nga ana tjetër egzistenca e raporteve të mësipërme të kredisë së brendshme mund të çojë në të ardhmen në çbalancime në ekonomi.

Ndryshimi i tepricës së kredive si sistem bankar, tendencat e saj nga njëri tremujor në tjetrin duke e krahasuar me fundin e vitit 1997, (sipas gjendjes monetare) janë :

Sistemi bankar	dhjetor '97	mars '98	qershor '98	Shtator '98	Dhjetor '98
Teprica e Kredisë mln lekë	15835	16418	16892	17397	17692
Ndrysh.Tep. së kredisë mln lekë		583	1057	1562	1857
në % ndaj vitit '97		3.6	6.6	9.9	12

Për vitin 1998, rritja e tepricës së kredive për ekonominë nga sistemi bankar, siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, nuk arriti në nivelin e parashikuar në programin monetar. Deri në fund të vitit teprica e kredisë u rrit me rreth 1,8 miliardë lekë. Kredia e re e akorduar në vitin 1998 arriti në 5,8 miliardë lekë, ndërkohë që arkëtimet nga kreditë ishin 4.2 miliardë lekë. Raporti shlyerje / përdorim, për gjithë vitin, arriti në 72.4 për qind, gjë që tregon se kreditë e dhëna në vazhdimësi gjatë vitit 1998 janë shlyer rregullisht. Arkëtimet dhe përdorimet e reja të kredisë për vitin 1998 për bankat shtetërore dhe private janë si më poshtë:

	<i>përdorim+ristrukturim</i>	<i>arkëtime</i>
Bankat shtetërore	905.5	1827.1
Bankat private	4857.7	2403.6

(në milionë lekë)

Kredia në lekë në tepricën e kredisë gjatë vitit 1998 përbën 69,4 për qind, ndërsa në fund të vitit 1997 përbënte 77 për qind të stokut të kredive.

Kredia në valutë ka qenë preferencë e bankave private duke arritur në 41,6 për qind të tepricës së kredisë gjithsej. Në vitin 1997, ajo zinte 23 për qind të stokut të kredive si sistem bankar.

Si sistem bankar në strukturën e tepricës së kredive për vitin 1998, 43 për qind e përbën kredia afatshkurtër, ndërsa kredia me probleme zë 59,8 për qind të stokut të kredisë.

Për bankat private të huaja dhe me kapital të përbashkët në stokun e kredive të tyre në fund të vitit 1998 kredia afatshkurtër zë 73 për qind.

Në bankat me kapital shtetëror kredia afatshkurtër zë 22,1 për qind të tepricës. Gjendja e kredisë me probleme, në këto banka, është 79.8 për qind e tepricës së kredisë (BKT,BK,BTA).

Portofoli i kredisë si sistem bankar përbëhet nga 12607 milionë lekë, që është stoku i kredisë në bankat me kapital shtetëror dhe 5085 milionë lekë, stoku i kredisë në bankat me kapital privat dhe të përbashkët.

Vëmë re se, në përgjithësi, janë mbështetur me kredi nga bankat private dhe të huaja degë të tilla të ekonomisë që nuk luajnë ndonjë rol të madh në treguesin prodhimit të përgjithshëm të vendit, si tregtia, sivekultura, ndërtimi, peshkimi, turizmi, riparim automobilash e pajisje shtëpiake etj. Vetëm Banka Alpha Credit kreditë e akorduara i ka në degën e industrisë së përpunimit agrourbues.

Rritja e tepricës së kredive sipas bankave gjatë vitit 1998 paraqitet :

Bankat	Stoku i kredive në dhjetor '97	Stoku i kredive në dhjetor '98	Rritja e stokut të kredive (mln lekë)
BKT *	2079.8	1525.3	(554.5)
BK *	9454.3	9704.7	250.4
B. DARDANIA	220.5	159.1	(61.4)
BISH	2520	3674	1154
B.TIRANA	159.1	743.5	584.4
BKG	0	0	-
BNT MALAJZIANE	28.3	210.5	182.2
B.ALPHA CREDIT	0	297.8	297.8

* - Nga BKT ka kaluar në BK kredia për Entin e Banesave.

Banka Italo Shqiptare është banka me rritjen më të madhe të stokut të kredive në krahasim me të gjitha bankat e tjera që ushtrojnë aktivitetin kreditues në vendin tonë. Portofoli i kredisë në fund të 1998 përbën 42 për qind të totalit të aktivitetit dhe 68 për qind të totalit të depozitave.

Banka e Tiranës ka përdorur 48 për qind të kufirit të kreditit.

Banka Ndërkombëtare Tregtare ka përdorur rreth 82 për qind të kufirit të shpërndarë.

Banka Alpha Credit edhe pse aktivitetin kreditues e ka filluar në tremujorin e dytë të vitit 1998, rezulton me një realizim të kufirit të kreditit 62 për qind.

Banka Kombëtare Greke gjatë gjithë vitit 1998 nuk ka dhënë kredi.

Kështu, për vitin 1998 mund të arrijmë në këto përfundime:

- Kufiri i kreditit i përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në programin monetar për këtë vit ishte i mjaftueshëm dhe nuk u bë pengesë për kreditimin e ekonomisë nga sistemi bankar.

-Bankat private kanë preferuar të japin kredi në valutë, edhe pse kursi i këmbimit të lekut me valutat kryesore ka qenë i stabilizuar.

-Dominuese në kreditimin e ekonomisë ka qenë kredia afatshkurtër, gjë që tregon se mbështeten me kredi biznese të vogla dhe jo projekte të rëndësishme për investime në degë kyçe për ekonominë shqiptare.

-Shkalla e ulët e realizimit të kufirit të kreditit aktualisht pasqyron investimet shumë të sigurta të parave në bono thesari dhe depozita në valutë të huaj.

-Ekziston një "kontradiktë" midis bankierëve dhe biznesmenëve në dhënien e kredisë. Arsyet, sipas bankierëve, janë projektet e hartuara me mangësi. Aplikimet për të marrë kredi nga biznesmenët shqiptarë në shumicën e rasteve janë të pashoqëruara me një plan biznesi bindës dhe të detajuar.

-Në të njëjtën kohë, element i rëndësishëm për kreditimin nëpërmjet bankave private, është historia e marrëdhënieve të klientit me bankën. Është shumë e rëndësishme, që një klient i cili aplikon për kredi, të ketë patur llogari me bankën dhe veprime të vazhdueshme në të. Përmirësime në këtë drejtim do të sjellë në të ardhmen sistemi i pagesave.

-Mendojmë që të gjitha bankat e huaja private kanë patur dhënien e kredive në nivele të ulëta, duke qenë më tepër të interesuara të ruajnë paratë për strategjinë e së ardhmes dhe duke minimizuar sa më shumë riskun.

-Problem në kreditimin e rajoneve dhe komunave të tjera (veç Tiranës, Durrësit, Fierit) mendojmë është dhe shtrirja e degëve të bankave private të huaja në të gjithë territorin e Shqipërisë. Në këtë drejtim, dihet që vendi ynë ka një mungesë infrastrukture të theksuar duke filluar nga rrugët e deri tek linjat telefonike, të mos përmendim pastaj rendin dhe qetësinë që lënë për të dëshiruar. Ngjarjet e shtatorit ndikuan shumë negativisht në besimin e investitorëve për të kërkuar kredi dhe në aktivitetin kreditues të bankave. Ndryshe nga vitet e tjera, ku tremujori i tretë dhe i katërt janë pikat kulmore të aktivitetit kreditues të bankave, pasiguria dhe gjithçka e tronditur për dy ditë treguan se risku i vendit është në nivele shumë të larta.

-Në Shqipëri, paratë e grumbulluara nga kontrabanda dhe trafiqet e ndryshme, investohen pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Kjo zvogëlon deri diku kërkesën për kredi.

-Stabilizimi i situatës brenda vendit dhe në rajon do të shtonte besimin e bankave private për të zgjeruar aktivitetin kreditues për ekonominë dhe rrjetin e tyre në të gjithë territorin e vendit.

Për vitin 1999 Banka e Shqipërisë në programin monetar ka planifikuar një kufi krediti si sistem bankar prej 8 miliardë lekë, i shpërndarë si më poshtë:

Bankat	(Në milionë lekë)				
	T-1	T-2	T-3	T-4	Vjetore
1.Banka Italo-Shqiptare	580	720	870	720	2890
2.Banka Dardania *	0	70	80	70	220
3.Banka Tirana	380	470	570	470	1890
4.Banka Komb. Treg. Greke	70	290	340	290	990
5.Banka Alpha Credit	200	250	300	250	1000
6.Banka Tregtare Ndërkombëtare	90	110	140	110	450
7. Banka Amerikane e Shqipërisë	280	90	100	90	560
Totali	1600	2000	2400	2000	8000

* Bankës Dardania i është ndaluar që të japë kredi në tremujorin e parë, ndërsa për të ardhmen do të vendoset në një kohë të dytë. (Kjo shpërndarje konsiderohet si paraprake, pasi në bazë të zhvillimeve Banka e Shqipërisë ruan të drejtën për të ndryshuar dhe rishpërndarë kufirin e një tremujori në tremujorët e tjerë.)

Mbështetur në këtë shpërndarje, Departamenti i Politikës Monetare në datën 18.02.1999, me anë të një shkrese drejtuar bankave të mësipërme, ju kërkoi që brenda datës 26.02.1999 të jepnin prononcimin e tyre lidhur me mundësitë për realizimin e kufirit të kreditit për vitin 1999, synimet, problemet dhe vështirësitë që ekzistojnë për realizimin e tij.

Në përgjithësi, të gjitha bankat shprehen se qëllimi i aktivitetit të tyre nuk është vetëm të krijojnë një klientelë të bazuar në depozita dhe transferta, por dhe të zhvillojnë një veprimtari krediti, duke krijuar vende të reja pune nëpërmjet mbështetjes së biznesit privat me kredi. Por, kjo bie në kundërshtim me politikën e tyre kundrejt riskut. Vlerësimi i riskut nga secila bankë është një nga pikat kyçe, kur bëhet fjalë për të marrë një vendim për akordim kredie. Disiplinimi i riskut shmang huatë me probleme dhe përmirëson cilësinë e portofolit të kredisë.

Të gjitha bankat që kanë të drejtë përdorimi të kufirit të kreditit të shpërndarë nga Banka e Shqipërisë për vitin 1999, pavarësisht se synojnë të realizojnë kufirin e kreditit, ngrenë disa probleme dhe shqetësime që hasin gjatë akordimit të kredisë :

-Pasiguria politike, ndaj së cilës biznesi privat është shumë i ndjeshëm. Duke njohur rëndësinë e madhe që ka arritja e një stabiliteti politik dhe ekonomik, mbetet detyrë dhe përgjegjësi e shtetit shqiptar dhe e të gjitha forcave politike në vend, krijimi i një klime sigurie për investime në vend.

-Në Shqipëri mungon një qarkullim gjysmë i mbyllur i fondeve dhe transferta e parave vonon gati 20 ditë. Pagesat për çdo lloj transaksioni kryhen me lekë në dorë.

-Të punuarit me bankat nuk është bërë edukatë e përditshme e biznesmenëve. Ata i drejtohen bankës vetëm në raste kur kanë nevojë pra, kur kërkojnë hua, ndërkohë që marrëdhënia e tyre duhet të jetë konstante. Që banka të japë kredi ajo duhet së pari ta njohë klientin dhe më pas të bëjë vlerësimin për dhënie kredie.

- Vështirësia e vlerësimit të kolateralit është një pengesë tjetër për kreditimin e bizneseve private. Ekziston vështirësia e garantimit të pasurive të paluajtshme, ka paqartësi për regjistrimin e hipotekave. Nuk ekziston një vlerësim paraprak i pasurive, por ky vlerësim bëhet gjatë negociimit për dhënie kredie.

-Bankat nuk u besojnë klientëve për dhënie kredie. Mungesa e aktiviteteve të qëndrueshme nuk u jep siguri atyre për qëllimin e përdorimit të huasë. Në këtë rast banka nuk ka siguri në kthimin e kredisë.

-Nuk ekzistojnë ligje për përcaktimin e kolateralit, vlerësimin e garancisë dhe ekzekutimin e tyre. Hartimi i një kornize të plotë ligjore është i domosdoshëm për të patur një shumëllojshmëri kolateralesh.

-Korrupsioni në sistemin e drejtësisë krijon vështirësi në zgjidhjen e problemeve që kanë bankat.

Bankat private që filluan aktivitetin kreditues në vitin 1998 nuk kishin krijuar portofolin e tyre dhe vazhdojnë të punojnë për plotësimin e stafit që ndjekin kreditin.

Nga ana tjetër, nuk janë vetëm fondet e vetë bankave që mbulojnë kërkesat për kredi të bizneseve. Njëpërmjet bankave dhe fondacioneve të ndryshme, në Shqipëri kalohen projekte financimi që nuk përfshihen në kufirin e kreditit. Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave nuk kanë të dhëna të plota për këto aktivitete. Për grumbullimin e këtyre të dhënave do të fillojë puna në vitin 1999 sipas rekomandimeve të misionit shumësektorial të statistikave kombëtare. Megjithatë, mund të themi që gjatë vitit 1998 kredi janë dhënë nga FEFAD, i cili në fund të vitit kishte një portofol prej 615 milionë lekësh (me një xhiro të akumuluar prej rreth 1,3 miliardë lekë). Ky institucion ka marrë licencë bankare këtë vit dhe do të vazhdojë të kreditojë me fondet e KFW dhe me fondet e veta si bankë. Gjithashtu, ka projekte të tjera që mbështesin bizneset me para të trajtuara nga : GTZ, Agjencia e Bankës Botërore IFC, projektet e SME, sponsorizimet e ndryshme nga fondacioni Soros dhe fondacione të tjera.

Gjatë vitit 1999, si dhe më parë, nga sistemi bankar do të lëvrohen shumë kredi të huaja dhënë Qeverisë Shqiptare për të cilat janë lidhur marrëveshje. Kështu, veç kredive që trajtojnë bankat shtetërore, janë lidhur marrëveshje me bankat private për: kredinë e qeverisë greke prej 5 miliardë dhrahmish (ose rreth 2,5 miliardë lekë) që është me kushte lehtësuese (afati i shlyerjes 10 vjet, interesi 9 për qind në vit dhe periudha e pagimit të këstit të parë fillon pas 2 vjetësh); kredinë e Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim nga e cila deri tani janë dhënë 145 milionë lekë. Veç këtyre, ka edhe projekte të tjera që mbështesin biznesin e vogël dhe të mesëm, si dhe programe për mbështetjen e biznesit të madh me investime si ai i Korporatës Ndërkombëtare Financiare (që bën pjesë në Grupin e Bankës Botërore).

Një burim tjetër i financimit të bizneseve është dhe paraja që vjen nga dërgesat e emigrantëve. Nga të dhënat e Bilancit të Pagesave mësojmë që dërgesat e emigrantëve gjatë vitit 1998 vlerësohen të jenë 521 milionë dollarë amerikanë, ndërkohë që në sistemin bankar depozitat në valutë janë rritur vetëm 28 milionë dollarë amerikanë. Për vitin 1999 janë parashikuar, dërgesa, rreth 350 milionë dollarë amerikanë (aq sa ishin parashikuar në fillim të vitit 1998). Kjo shumë parash qarkullon në shtesë të parave të arkëtuara nga aktivitete të paligjshme (klandestinë, drogë, prostitucion, tranzit, etj.).

Për arsytet e mësipërme dhe kufizimet që krijon në dhënie kredie gjendja e kredive afatshkurtra në portofolet e bankave në fund të vitit 1998 (bankat private 3.615 milionë lekë, bankat shtetërore dhe Dardania 4.015 milionë lekë) mendojmë që kufiri i kreditit të shpërndarë në vitin 1999 është i lartë dhe bankat që do të kreditojnë ekonominë **nuk do ta rrisin tepriçën e tyre të kredive të dhëna nga fondet e depozituesve me 8 miliardë lekë.**

